

Shkruar nga: Hana Kaja

ESE

Tema: Si mund të shfrytëzohen fondet e BE-së në të mirë të komunitetit ku jetoni?

Cila fjalë ju bie në mend kur dëgjoni fjalën 'Kosovë'? Ju siguroj që nuk ka përgjigje të gabuar, se të gjitha i kemi; të mirën e të keqën, të bardhën e të zezën. 'Kosova', 'Kosovo', 'një shtet', 'një sistem'; shumë popuj të cilët punojnë që pyetja më lartë të marrë përgjigje me vetëm sinonime pozitive, e pa antonime të tyre.

Kur flas për veten, mendoj për Kosovën, e kur flas për Kosovën, mendoj për veten. Si dëshiroj ta shoh Kosovën time? Çfarë do dëshiroja të shihja sa herë dal në rrugë? Por, me kujdes! Nëse shikoj gjatë rrezikoj të pësoj aksident rrugor, se me të vërtetë ka shumë makina! Andaj, para se të kërkoj më shumë gjelbërim e biçikleta, duhet fokusuar në vetëdijesimin e gjerë e të gjatë të bashkatdhetarëve tanë për çështjen e mjedisit. Një proces shumë më i vështirë sesa unë e imagjinoj, por i mundshëm doemos, se shpirti më loton kur shoh se si formohen re nga tymi i Obiliqit!

Ah, sikur matanë lagjes të kishte ulëse ku do mund të ulej ai çifti i vjetër, dashuria e të cilëve nuk është venitur as pas pesëdhjetë vitesh martesë. E në ulësen pak para shenjës "RECIKLO KËTU" do gjendej një grup adoleshentësh me çanta pëlhure dhe shishe ujë nga qelqi, me faqe të skuqura e me buza në gaz. Vendi nga ku ata ishin kthyer, "Qendra për të Rinj" ishte pothuajse vend magjik; nuk kishte njeri që kalonte nga ajo derë e që nuk ishte mbushur me energji pozitive. Paramendoj sa mirë do e zbukuronte ky objekt çdo lagje të këtij qyteti të stërmadh. Do ishte hapësirë ku do mund të relaksoheshe me miqtë e tu, do mund të ulëshe dhe të kënaqeshe në shoqëri me vetveten, do të mund të mbledhje një grup me interesa të përbashkëta dhe të flisnin deri në ditën e nesërme. Shkurt e shqip, do kishim një hapësirë për të rinj që nuk i kanë qejf kafet e diskotekat, se jo të gjithë tërhiqen nga dritat që vezullojnë mbrëmjen e të premtës. E rrugës nga kjo qendër nuk do të më mbusheshin sytë me lot për fëmijët që nxeheshin me tubë të gazrave të automjeteve, prindërit të cilëve mundoheshin t'ua siguronin një qindarkë për dy copa bukë.

Në këto momente gjersa mendoj për Kosovën utopike, në zemër më therrin qindra thika duke e ditur që këto familje kërkojnë ushqim nëpër shporta të mbeturinave, fëmijët mbajnë në mend fyerje, sharje, e jo mësimë shkollore, e strehim gjejnë vetëm atëherë kur fati i tyre vendosë të ketë mëshirë për ta. Rrugës së sheshit imagjinoj një Kosovë që ka strehimore për këta njerëz, këta persona për të

cilët Migjeni kishte vajtuar vite më parë. Në një univers paralel do kthehesha në shtëpi me fare pak brenga në mendje, do i bëja gati librat sipas orarit shkollor dhe do e lexoja një vepër nga Tolstoy-i. Ditën e nesërme kur nëna do më përcillte në mësim do thoshte “eh, sa shumë ka ndryshuar ky vend që nga koha kur unë vijoja mësimet këtu...”, do më puthte dhe do vazhdonte rrugën e vet për në punë, e unë do të hyja në shkollën që kishte fare pak mangësi. Pas pak minutash do shikoja eksplozime në kimi, shkëndija elektriciteti në fizikë, ameba në biologji dhe erupsione në gjeografi; të gjitha këto në kabinetet tanë të përgatitur për ta shuar, e njëkohësisht për ta shtuar kureshtjen e nxënësve. Sikur t’i kisha këta laboratorë tani! Atë natë do më nxinte gjumi me vështirësi, se nga mësimet e sotme pyetjet vetëm shkonin duke u shumëzuar në kokën time. E atëherë do buzëqeshja, se do isha tejet falënderuese për kushtet të cilat mi mundësoi Dardania ime, me ndihmën e shteteve që na rrethonin.

Kam një imagjinatë goxha të guximshme, ë? Besoj që nuk ka nevojë ta përsëris që e gjithë kjo bëhet më vështirë sesa që thuhet. Mirëpo, një gjë është e pamundshme vetëm nëse ne themi që ajo nuk mund të bëhet. Andaj, e di që një ditë do jetoj në Kosovën e ëndrrave të mia, të tua, e të tona.